



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT  
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNIKA

---

**ZYRA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS:**

**SHBALL KONKURS PËR PLOTËSIMIN E POZTTES SE VENDIT TË LIRË TË PUNËS PER AFAT  
TE CAKTUAR PËR:**

**Përkthyes nga gjuha shqipe, në serbisht dhe anasjelltas**

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	<b>Përkthyes nga gjuha shqipe, në gjuhen serbe dhe anasjelltas</b>
<b>Kategoria funksionale:</b>	Niveli Profesional
<b>Lloji i vendit të punës:</b>	<b>Punëtor me afat te caktuar/kontratë mbi vepër</b>
<b>Departamenti:</b>	Departamenti i Administratës
<b>Divizioni:</b>	Divizioni i Përkthimeve
<b>Raporton te:</b>	Udhëheqësi i Divizionit të përkthimeve

**Qëllimi i vendit të punës**

Ofrimi i shërbimeve të përkthimit për nevoja pune të ZPRK-së dhe përkthimin simultan.

**Detyrat kryesore:**

1. Përkthen me shkrim materiale, shkresa, raporte, dokumente dhe akte të ZPRK-së;
2. Përkthim të aty për atyshëm gjatë takimeve të ZPRK-së nga gjuha Shqipe në atë Serbe dhe anasjelltas;
3. Përkujdeset për strukturën e fjalëve dhe të fjalive në dokumentet e përkthyer;
4. Ndhmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë për tekstet e përkthyer;
5. Asiston në përpilimin e terminologjisë së unifikuar ligjore dhe arsimore nga gjuhët zyrtare.
6. Ndhmon dhe shoqëron anëtarët e ZPRK-së në takime pune dhe vepron si përkthyes/shpjegues;

7. Bënë edhe lektor imin e teksteve të përkthyer.
8. Kryen detyra tjera – në përputhje me ligjet dhe rregulloret momentale – të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe.
9. Mirëmban sistemin e arkivimit të materialeve të përkthyer në mënyrë korrekte dhe konfidenciale.
10. Është përgjegjës për cilësinë dhe saktësinë e përkthimeve.

### **Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar**

Përgatitje superior shkollore, kandidati duhet të ketë të kryer fakultetin.

Së paku tri (3) vjet përvojë përkatëse profesionale në përkthime.

Kandidati për pozitën e Përkthyesit duhet të jetë njohës i mirë i drejtshkrimit dhe terminologjisë juridike dhe administrative; Të ketë shkathtësi të mira ndër njerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës; Shkathtësia dhe aftësia në përdorimin e kompjuterit dhe të softuerëve aplikativë, si: MS WORD përfshirë përpunimin e avancuar të tekstit, MS EXCEL dhe MS OUTLOOK është e domosdoshme

### **Kushtet e pjesëmarrjes ne rekrutim: Për të gjithë ata që marrin pjesë në Konkurs për afat të caktuar:**

*I. Në Shërbimin Civil kane të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për te vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe te cilët kanë aftësitë fizike, qe kërkohen për pozitën përkatëse.*

### **Procedurat e konkurrimit:**

*Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit.*

### **Kohëzgjatja e emërimit:**

*Emërimi është me kohë te caktuar.*

### **Data e mbylljes se Konkursit:**

*Konkursi do te jete i hapur për dorëzimin e kërkesave 7 ditë nga dita e publikimit dhe data e fundit që kandidatet kanë mundësi t'i dorëzojnë ato deri me: 20.07.2018.*

**Paraqitja e kërkesave:**

*Aplikacionet mund të merren në Njësinë e Personelit të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, e cila gjendet në adresën: Ndërtesa e Kuvendit p.n. në Prishtinë. Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmive të kërkuara sipas Shpalljes për rekrutim dorëzohen në Njësinë e Personelit të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës,*

*Aplikacionit duhet bashkëngjitur të dhënat biografike për përvojën paraprake dhe të gjitha kopjet e kualifikimeve (diplomave, certifikatave të trajnimeve, dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja dhe përdorimit të kompjuterit).*

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha Komunitetet në Kosovë.

"Komunitet jo-shumice dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

*Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.*

Aplikacionet tuaja mund t'i dorëzoni personalisht në recepcionin e Ndërtesës së Kuvendit të Kosovës në Prishtinë (rruga Nëna Terezë p .n.) apo përmes postës. Për informata të tjera plotësuese mund të drejtoheni në telefonin 038-211-662 ose në:

[www.president-ksgov.net](http://www.president-ksgov.net)